# Analiza&Komente

## Krenarë të pambështetur: "Bafta", "Oskar", çfarë i duhet tjetër këtij vendi për t'i përkrahur talentet?

Sa është e vështirë të jesh artist në Kosovë, që në mesin e çështjeve "madhore" të shtetit të sigurosh mbështetje për artin dhe kulturën? Pavarësisht mjaft diskutimeve, puna dhe angazhimi i artistëve po vazhdon të mos çmohet as si vlerë shoqërore, por as edhe financiare. Si e tillë, të qenit artist në Kosovë assesi nuk po mund të tejkalojë perceptimin e një "hobi" që shërben për t'i përmbushur nevojat shpirtërore të artistit e jo si një profesion i mirëfilltë me anë të të cilit sigurohet një jetë normale.

Paradoks i madh është ta mendosh se e vetmja fushë që ka ndikuar pozitivisht në ndërtimin e imazhit të Kosovës në botë është zhvilluar dhe mbijeton kryesisht në baza vullnetare. Sa herë të flitet për artin dhe kulturën, e në veçanti për filmin në Kosovë, na kujtohet teoria e "kalorësit të lirë", ku qeveria nuk heziton të mburret me sukseset e tyre nëpër botë, por jo edhe t'i mbështesë me të

Për më tepër, vendimet e shpeshta "ad hoc" dhe anashkalimi i profesionistëve për t'u koordinuar lidhur me politikat e reja për kulturën në përgjithësi janë degë e "dështimit" institucional në këtë fushë. Filmat po mbështeten në festivale kryesisht të "Klasit A", ku Kosova rrallëherë ka mundësi të jetë pjesëmarrëse për shkak të buxhetit të ulët që i karakterizon filmat në Kosovë. Mbështetja fillon dhe përfundon me "biletë aeroplani" për pjesëmarrje në një festival të caktuar e që nuk mund të konsiderohet si investim madhor në këtë fushë. Si dhe përzgjedhja e palogjikshme e projekteve fituese për grante institucionale ka kontribuuar edhe më tej në degradimin e kësaj fushe. Kjo më mirë reflektohet edhe për faktin e çuditshëm se në Kosovë mbështetja institucionale quhet "subvencion", term ky që zakonisht përdoret për bujqësi e nuk njihet si term i denjë për të përshkruar investimet në kinematografi.

Megjithatë, pavarësisht të gjitha prob-



**Andi Emini**

Sallonet e së Martës janë një nismë javore e Institutit Demokraci për Zhvillim (D4D). Salloni ka format gjysmëformal sipas rregullës "Chatham House" dhe pa prani të medieve. Diskutimi mbledh rreth vetes ekspertë e analistë, politikanë e publicistë për të reflektuar dhe kërkuar konsensus

UBT
LEADERSHIP and INNOVATION
Education | Research | Training | Consulting | Certification

PROGRAMET E AKREDITUARA

SHKENCA KOMPJUTERIKE DHE INXHINIERI
(Baçelor dhe Master)
- Inxhinieri e Sistemeve Softuerike
- Baza e të Dhënave dhe Sisteme e Informacionit
- Grafika Kompjuterike dhe Multimedia
- Web Programim
- Rrjeta dhe Telekomunikacion
- Robotikë dhe Sistemet Intelegjente
- Informatikë Biomjeksore
- Siguria dhe Sigurimi i Informacionit
- Multimedia dhe Vizualizim

MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI
(Baçelor dhe Master)
- Financa, Banka dhe Sigurime
- Kontabilitet, Auditim dhe Tatime
- Marketing dhe Shitje
- Menaxhment, Ndërmarrësi dhe Inovacion
- Biznes Ndërkombëtar
- Logjistikë dhe Prokurim

MEKATRONIKË DHE MENAXHMENT
(Baçelor dhe Master - i vetmi i akredituar në vend)
- Menaxhim i Mekatronikes
- Automatizimi Industrial dhe Kontrolli i Procesit
- Dizajn i Produkteve Industriale
- Robotikë dhe Sisteme Intelegjente
- Inxhinieri Biomjeksore
- Inxhinieri e Telekomunikimit
- Inxhinieri Mekanike
- Inxhinieria e Aeronautikes

SHKENCA POLITIKE (Baçelor)
- Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci
- Integrime Evropiane
- Administratë Publike

SISTEMET E INFORMACIONIT DHE MENAXHMENT
(Baçelor dhe Master)
- Sistemet e Informacionit të Biznesit
- Sistemet e Informacionit - GIS (Geo Information Systems)
- Sistemet e Informacionit të Bibliotekave dhe të Arkivave
- Statistikat, Procesimi dhe Simulimi i të Dhënave
- Siguria e Informacionit dhe Privatësia
- Komerci Elektronik (E-Komerci)

ARKITEKTURË DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR
(Baçelor dhe Master)
(I vetmi privat i akredituar në vend)
- Arkitekturë e Qendrueshme

sjellë një rënie të cilësisë së artit në përgjithësi, për faktin që sot një artist duhet të punojë në profesione të tjera për t'i siguruar të mirat materiale, kurse profesionin e artistit ta kalojë në plan të dytë.

Po të shikosh në retrospektivë, zhvillimi i kinematografisë në Kosovë ka kaluar në tri periudha kyçe, të cilat janë përcjellë me shumë sfida. Në fillet e saj - në periudhën e paraluftës kinematografia ishte tejet e varfër dhe e mangët, e kjo shënoi rënie e stagnim të mëtejmë në periudhën e luftës. Rimëkëmbja e kinematografisë ka shënuar hapat e parë të zhvillimit tek pas përfundimit të luftës. Kjo rimëkëmbje e lehtë ndodhi kur kuadrot e vjetra filluan që të zëvendësoheshin me gjeneratat e reja kreative. Ky ndërrim ndikoi drejtpërsëdrejti tek rritja e interesimit të publikut dhe institucioneve për këtë fushë, por që ende lë shumë për të dëshiruar.

Ndoshta burimi kryesor i problemeve dhe sfidave në këtë fushë sillet rreth mbështetjes dhe ndihmës financiare. Politikat dhe proceset e ndërlikuara burokratike për mbështetjen financiare të filmit e kanë bërë thuajse të pamundur përfitimin nga fondet publike. Zyrtarët brenda institucioneve publike janë vështirë të qasshëm dhe pothuajse joprofesionalë në fushën e kulturës, të cilët jo vetëm që nuk po e mbështetin artin, por shpesh edhe e pengojnë atë. Vetë fakti që pothuajse çdo film që po ecën tutje po arrin vetëm falë mbështetjes së pakursyer nga jashtë, tregon shumë në këtë drejtim.

kosovare ka kaluar nëpër momente pozitive e madhështore. Kurdo që ka munguar mbështetja institucionale, njerëz të vullnetit të mirë - kryesisht të rinj, gjithmonë u kanë qëndruar afër ekipeve realizuese të kinematografisë. Natyrisht, nuk duhet neglizhuar plotësisht mbështetja institucionale për kinematografinë dhe talentet në përgjithësi, sepse në raste të shpeshta ajo edhe ka mbështetur projekte të ndryshme kur është vërejtur potenciali që do ta ketë filmi, por që ende mbetet e limituar. Megjithatë, problemi i mbështetjes së talenteve qëndron në atë se ata po merren parasysh seriozisht vetëm pas arritjes së sukseseve ndërkombëtare, por që në fakt rruga deri atje ka qenë shumë e lodhshme dhe sfiduese. Si në rastin e filmit "Shok", ku buxheti për filmat u dyfishua pas marrjes së çmimeve ndërkombëtare, reflekton reagimin e vonshëm të institucioneve vendimmarrëse, por që gjithsesi është një lëvizje pozitive.

Të gjithë jemi të pajtimit që duhet të ndryshohet rrënjësisht mënyra sesi mësohet arti nëpër shkollat tona, që gjeneratat e reja të mos rriten duke mësuar që arti ngërthen vetëm atë figurativ, por që është një fushë shumë më e gjerë ku secili prej tyre mund ta gjejë veten. E të gjitha këto arrihen duke punuar kolektivisht, sepse kur ekziston puna kolektive, ekziston edhe guximi e kur ekziston guximi dhe vullneti qytetar, presioni ndaj vendimmarrësve është shumë më i madh dhe kështu rritet mundësia për ndryshimin e politikave regresive në këtë fushë!

hura. Fjala e hapjes postohet në kanalin e Salloneve në "YouTube". Secili Sallon përcillet me editorial që publikohet në "Zëri" të martën e ardhshme dhe në faqen elektronike të D4D-së. Podcastet bazuar në editorial mund t'i gjeni në uebfaqen tonë. Sot me fillim nga ora 16:45 do të mbahet Salloni i radhës me temën: "Pushimi i përbashkët prindëror: Një hap për ta thyer pabarazinë gjinore?"


- Restaurim Arkitekturor
- Dizajn i Interierit

**INXHINIERI NDËRTIMORE (NDËRTIMTARI) DHE INFRASTRUKTURE** (Baçelor dhe Master)
(I vetmi privat i akredituar në vend)
- Inxhinieri Strukturore - Konstruktiv
- Menaxhimi i Ndërtimtarise dhe Teknologji
- Infrastrukturë Rrugore
- Inxhinieri e Ujërave - Hidro
- Inxhinieri e Gjeoteknikes
- Inxhinieri e Materialeve

**JURIDIK** (LLB - Baçelor)
- Civile
- Penale
- Ndërkombëtare

**E DREJTA BIZNESORE NDËRKOMBËTARE DHE EVROPIANE** (LLM - Master)

**MEDIA DHE KOMUNIKIM** (Baçelor dhe Master)
- Gazetari
- Komunikim
- Menaxhimi i Medias
- Marrëdhëniet me Publikun
- Regjia Televizive
- Gazetaria On-Line
- Kamera dhe Fotografia

**POLITIKA PUBLIKE DHE MENAXHIM** (Master)
- Politika Publike
- Menaxhimi Publik

**INXHINIERI E ENERGJISË** (Baçelor)
- Bazat e Burimeve të Energjisë
- Ruajtja e Energjisë
- Energjia Efiçiente
- Teknologjia e Informacionit
- Menaxhimi i Energjisë
- Eklektikë Elektronike
- Sistemet e Qëndrueshme
- Izolimi i Ndërtesave
- Sistemet e Ngrohjes dhe Ftohjes

**INXHINIERI E ENERGJISË EFIÇIENTE**
(Diplomë profesionale - I vetmi i akredituar në vend)

**INFERMIERI** (Baçelor)

**DIZAJN I INTEGRUAR** (Baçelor)
- Dizajn Grafik dhe i Komunikimit
- Dizajn Mode dhe Tekstilit
- Dizajn i Produkteve
- Dekorim i Ndërtesave dhe Mobilimi

**SHKENCAT E USHQIMIT DHE BIOTEKNOLOGJI**
(Baçelor)
- Teknologji e Ushqimit
- Nutricion (Të Ushqyerit)
- Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë e Ushqimit

**Apliko online: www.ubt-uni.net/apliko**
**Lagjja Kalabria p.n., Prishtinë, Tel:038 541400 Mob:044 541400,**
**Email: info@ubt-uni.net**